

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Ndërmjet

Qeverisë së Republikës së Kosovës

Ambasadës Mbretërore Norvegjeze dhe

Grupit Ballkanik për Hulumtime të Politikave

Lidhur me

**MBËSHTETJE PËR QEVERINË E KOSOVËS, KRYEMINISTRIN, ZYRËN E KRYEMINISTRIT DHE ZËVENDËS
KRYEMINISTRIN PËR INTEGRIME EVROPIANE, ZHVILLIM DHE DIALOG, NËN KORNIZËN**

**“MBËSHTETJA E AGJENDËS SË PAQES DHE SHITËTË-NDËRTIMIT DHE KËSHILLIMI I AGJENDËS
EVROPIANE PËR KOSOVËN”.**

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë, të përfaqësuar nga Ambasada Mbretërore Norvegjeze dhe Grupi Ballkanik për Hulumtim të Politikave, të referuara si Subjekte; ndajnë objektiva të ngjashëm dhe dëshirojnë të konfirmojnë bashkëpunimin në mbështetje të Qeverisë së Republikës së Kosovës në agjendën e dialogut me Serbinë. Është në interesin e të gjitha subjekteve që t'i ofrohet mbështetje Qeverisë së Republikës së Kosovës me qëllim të ngritjes së paqes dhe prosperitetit për Kosovën.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i entiteteve është të ofrojnë mbështetje për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Kryeministrin, Zyrën e Kryeministrit, Zëvendëskryeministrin për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog.

Neni 2

Synimi

Subjektet plotësojnë përpjekjet e BE-së dhe angazhimin e Kosovës për të punuar në këtë agjendë, dhe projekti synon të mbështesë dhe forcojë kapacitetet e Kosovës, konsensusin dhe shtrirjen e informacionit për të avancuar më tej këtë proces. Duke ndihmuar Qeverinë e Republikës së Kosovës, Memorandumi i Mirëkuptimit dhe mbështetja pasuese synojnë të forcojnë institucionet e Kosovës dhe të avancojnë konsolidimin e saj shtetëror.

Neni 3

Fushëveprimi

Subjektet bien dakord të hyjnë në bashkëpunim, i cili ndër të tjera do të përfshijë mbështetjen për Qeverinë e Republikës së Kosovës përmes:

- Ofrimit të mbështetjes së ekspertëve dhe një grupi ekspertësh të nivelit të lartë për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Zyrën e Kryeministrit, Zëvendëskryeministrin për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog.
- Ofrimit të ekspertëve tematikë afatshkurtër brenda fushave kryesore të politikave në mbështetje të negociatave, bazuar në nevojën dhe kërkesën nga përfituesi.
- Mbështetjes së përpjekjeve të përfituesit në komunikimin dhe shtrirjen e informacionit për të ruajtur dhe forcuar mbështetjen publike dhe politike.
- Ofrimit të mbështetjes për të rritur përfshirjen dhe pjesëmarrjen e akterëve të tjerë, akterëve joqeveritarë etj.
- Modaliteteve të hollësishme që do të përpunohen midis tre palëve: do të funksionojë një mekanizëm konsultimesh midis Zëvendëskryeministrit (dhe Zyrës së Kryeministrit).
- Palët nënshkruese do të konsultohen dhe koordinohen rregullisht për të rritur mbështetjen për nevojat e subjektit.

Neni 4

Detyrimi

1. Qeveria e Republikës së Kosovës e mirëpret mbështetjen, do të akomodojë dhe do të përdorë maksimalisht mbështetjen e cilësisë;
2. Kryeministri, Zyra e Kryeministrit, Zëvendëskryeministri për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog do të angazhohen me aktivitete që do të hartohen dhe zbatohen brenda fushës së këtij memorandumit të mirëkuptimit;
3. Subjektet do të bien dakord mbi listën e ekspertëve dhe rekrutimin e ekspertëve të rinj që do të operohen nga Grupi Ballkanik për Hulumtim të Politikave me mbështetjen financiare të Qeverisë së Norvegjisë; kontratat do të hartohen për të përcaktuar përgjegjësitë e ekspertëve vetëm në mbështetje të përfituesit;
4. Ambasada Mbretërore Norvegjeze do të sigurojë mbështetje financiare për zbatimin e këtyre aktiviteteve, duke përfshirë kontratat e ekspertëve dhe aktiviteteve në lidhje me ta;
5. Grupi Ballkanik për Hulumtim të Politikave do të lehtësojë zbatimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve dhe shërbimeve kontraktuese.

Neni 5

Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje e mundshme midis subjekteve do të zgjidhet me negociata dhe marrëveshje.

Neni 6

Kohëzgjatja

Memorandumi i Mirëkuptimit do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga të gjitha Subjektet dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë prej tre (3) vitesh nga ajo datë, përveç nëse përfundon më herët.

Neni 7

Kopjet e Memorandumit

Memorandumi do të nënshkruhet në tre kopje, një për secilin Subjekt.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e autorizuar siç duhet, Subjektet vendosin nënshkrimet e tyre më poshtë.

Prishtinë, Kosovë 22 prill 2021

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës

Nënshkruar

Albin Kurti

Kryeministri i Republikës së Kosovës

Për Ambasadën Mbretërore Norvegjeze në Kosovë

Nënshkruar

Jens Erik Grondahl,

Ambasador

Për Grupin Ballkanik për Hulumtim të Politikave

Nënshkruar

Naim Rashiti

Drejtor Ekzekutiv